

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR  
“ECO LAND” SHPK  
PRONËSIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA**

**Neni 1**

**Ortaku i Vetëm**

- 1.1 Shoqëria “ECO LAND” SHPK (“Shoqëria”) është krijuar më datën si në vijim nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

**YARA HAWAY CABALLERO**, shtetase spanjolle, lindur më 21.04.1998, në Lagos (Nigeri), mbajtëse e pasaportës spanjolle me nr. PAR132191, dhe nr. personal A4876678500, e përfaqësuar rregullisht për nënshkrimin e këtij Statuti dhe Akti Themelimit nga Z. Ermal Mema në përputhje me Prokurën e Posaçme.

**Neni 2**

**Emri**

- 2.1 Emri i Shoqërisë është “ECO LAND” SHPK.
- 2.2 Në të gjithë dokumentat, faturat, reklammat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mjeteve të përdorura për trasmetim, emri i Shoqërisë do të përbëhet nga këto elementë:

- i. fjalët “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “SHPK”;
- ii. numri unik i identifikimit (NUIS);
- iii. kapitali i regjistruar dhe i paguar i Shoqërisë;
- iv. adresa e selisë; dhe
- v. njoftimi që shoqëria është në proces likuidimi, nëse është e aplikueshme

**Neni 3**

**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore në përputhje me parashikimet e ligjit shqiptar.

**Neni 4**

**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut (“Statuti”), Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligji për Shoqëritë Tregtare”) si dhe parashikime të tjera të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar.

**Neni 6**  
**Selia / Adresa e regjistruar e Shoqërisë**

- 6.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Blv. Gjergj Fishta, Pallati nr. 16, Kati i dytë, Tiranë, 1000, Shqipëri.
- 6.2 Me vendim të Ortakut të Vetëm mund të çelen ose të mbyllen, në Shqipëri ose jashtë territorit, njësi dytësore, degë ose filiale të shoqërisë.
- 6.3 Administratori zotëron të drejtën për të hapur ose mbyllur adresa sekondare të Shoqërisë në Shqipëri.

**Neni 7**  
**Objekti**

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është grumbullimi, përpunimi e tregtimi i bulmetit (qumësht, kos, djath e gjithë nënproduktet e tyre). Import – eksport. Çelje dhe operim i stabilimenteve ushqimorë dhe për shitjen e produkteve të bulmetit. Transport të bulmetit e të nënprodukteve të tij.
- 7.2 Me qëllim përmbushjen e objektit të mësipërm, Shoqëria ka të drejtë:
- a. Të lidhë çfarëdo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë, entitete private ose publike, Shoqëri, shtetin dhe organizata Shqiptare apo të huaja;
  - b. Të themelojë të gjithë llojet e shoqërive ose të marrë pjesë në shoqëri shqiptare ose të huaja apo në bashkime shoqërishe/*joint venture* ose në lloje të ndryshme biznesesh që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me atë të Shoqërisë;
  - c. Të themelojë degë ose agjenci në Shqipëri ose jashtë territorit shqiptar;
  - d. Të përfaqësojë biznese shqiptare ose të huaja të lidhur me qëllimin e Shoqërisë;
  - e. Të marrë hua, të pranojë garanci personale ose të një lloji tjetër, të marrë përsipër detyrime, të lëshojë instrumente financiare të maturuara ose të maturueshme (*drafts ose bills of Exchange*), çeqe, obligacione ose garanci financiare apo tituj të tjerë për llogari të Shoqërisë dhe të lëshojë garanci të tjera kolaterale.
  - f. Të ndërmarrë çfarëdo aktiviteti të lidhur, tregtar ose të një lloji tjetër dhe të procedojë me çdo veprim ligjor ose transaksion, drejtpërdrejt ose indirekt të lidhur me qëllimin e Shoqërisë, ose që kontribuon drejtpërdrejt ose indirekt në përmbushjen e qëllimit të Shoqërisë.
- 7.3 Shoqëria mund të realizojë në mënyrë plotësuese dhe rrjedhimisht në mënyrë rastësore dhe jo direkte, dhe në çdo rast vetëm me qëllim përmbushjen e qëllimit të biznesit të Shoqërisë, çfarëdo transaksioni

apo aktiviteti tregtar, industrial apo financiar në lidhje me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që mund të konsiderohen të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektit të korporatës.

- 7.4 Shoqëria mund të performojë operacione/veprime të tjera ndihmëse ose të lidhura, si dhe të gjithë aktivitetet e nevojshme ose të duhura me qëllim përmbushjen e qëllimit të biznesit në përputhje me ligjin.
- 7.5 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

### **Neni 8 Kapitali**

- 8.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë do të jetë 100 lekë, dhe përbëhet nga 1(një) kuotë e zotëruar plotësisht nga Ortaku i Vetëm, e cila përfaqëson 100% të kapitalit.
- 8.2 Kapitali do të paguhet në para në llogarinë bankare të Shoqërisë, të çelur pranë çdo banke në Shqipëri.

### **Neni 9 Transferimi i kapitalit/Kufizimet për transferimin**

- 9.1 Ortaku i Vetëm është zotëruesi i vetëm i kuotës së kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- 9.2 Kuota mund të transferohet lirisht, tërësisht apo pjesërisht, tek palë të treta vetëm përmes një marrëveshjeje të shkruar.
- 9.3 Kuota transferohet nëpërmjet trashëgimisë pa ndonjë marrëveshje të shkruar.

### **Neni 10 Zmadhimi i Kapitalit**

- 10.1 Ortaku i Vetëm mund të zmadhojë kontributin e tij në kapital në vlerën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin e Ortakut të Vetëm. Kontributi i Ortakut mund të jetë në të gjithë format e aseteve të lejuara nga ligji, duke përfshirë edhe kontributin në natyrë.
- 10.2 Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet gjithashtu me nënshkrimin dhe shlyerjen e kuotave të reja nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

### **Neni 11 Zvogëlimi i kapitalit**

- 11.1 Në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm, zvogëlimi i kapitalit të regjistruar do të kryhet në përputhje me legjislacionin tregtar.

## **STRUKTURA DREJTUESE**

**Neni 12**  
**Vendimet e Ortakut të Vetëm**

- 12.1 Vendimet kryesore në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë merren me vendim të Ortakut të Vetëm, i cili është organi më i lartë i Shoqërisë dhe që gëzon të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj. Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të regjistrohen në një regjistër vendimesh, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo fshihen. Për aq kohë sa ekziston vetëm një Ortak i Vetëm në Shoqëri, vendimet e Ortakut të Vetëm do të merren në formën e një dokumenti të vetëm të shkruar dhe nuk do të mbahet procesverbal.
- 12.2 Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë ushtrohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga përfaqësuesi i Ortakut të Vetëm.
- 12.3 Vetëm Ortaku i Vetëm ka të drejtë të vendosë për çështjet si më poshtë:
- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit;
  - f. pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit të regjistruar ose transferimit të kuotës);
  - g. të miratojë pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - gj. të vendosë mbi një bashkim, ndarje, shpërbërje dhe çdo lloj transformimi të shoqërisë;
  - h. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - i. të çelë dhe/ose mbyllë degë dhe zyra përfaqësimi;
  - j. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - k. të miratojë dhënien e huave dhe letrave me vlerë;
  - l. të marrë vendim për çështje të tjera që i atribuohen Ortakut të Vetëm sipas ligjit për shoqëritë tregtare dhe/ose nga ky Statut.

**Neni 13**  
**Administratori**

- 13.1 Administrimi i përditshëm i Shoqërisë do të bëhet nga 1 (një) ose më shumë Administratorë të caktuar dhe emëruar nga Ortaku i Vetëm. Administratori do të ketë të drejta dhe kompetenca të plota në lidhje me menaxhimin e Shoqërisë, përveç rasteve kur është vendosur ndryshe rast pas

rasti me vendim të Ortakut të Vetëm. Administrator(ët) e shoqërisë mëmë nuk mund të emërohen administratorë të filialit dhe anasjelltas.

- 13.2 Administratori ka kompetenca të plota për administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe të drejtën për miratimin e të gjitha vendimeve që mund t'i duken të përshtatshme për të realizuar dhe ushtruar objektin e Shoqërisë, me përjashtim të veprimeve ose çështjeve që rezervohen ose që duhet të përmbushen bashkërisht me një person ose njësi tjetër, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare ose këtë Statut apo vendimet e Ortakut të Vetëm, të miratuara herë pas here. Me anë të një autorizimi/prokure, administratori mund të delegojë një ose më shumë nga të drejtat e tij në lidhje me menaxhimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë tek palët e treta.

Në veçanti, Administratori ka të drejtat dhe detyrimet në vijim në lidhje me administrimin e Shoqërisë:

- a. drejtimin e veprimtarisë së përditshme të Shoqërisë, në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Ortakut të Vetëm, sipas rastit, të marra herë pas here;
  - b. paraqitjen përpara Ortakut të Vetëm çdo muaj një raport që përfshin të gjitha faktet dhe rrethanat që mund të jenë të rëndësishme, rezultatet financiare të periudhës përkatëse, si dhe parashikimin për tremujorin në vazhdim;
  - c. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe kundrejt autoriteteve publike;
  - d. çeljen, operimin dhe mbylljen e llogarive bankare të Shoqërisë;
  - e. lidhjen e marrëveshjeve dhe transaksioneve me palët e treta;
  - f. lëshimin e faturave, kërkesave për shlyerjen e pagesave dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
  - g. punësimin dhe largimin nga puna të stafit të Shoqërisë dhe caktimin e pagave, përfitimeve dhe shpërblimeve të tjera në përputhje me politikat dhe udhëzimet e miratuara nga Ortaku i Vetëm sipas rastit;
  - h. kryerja e veprimeve të tjera në lidhje me veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë në frymë të ligjit dhe sipas Aktit të Themelimit dhe Statutit;
  - i. mbajtja e librave të llogarive, siç përshkruhet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit;
  - j. përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë dhe auditimi i tyre nga auditorët e jashtëm nëse kërkohet nga ligji ose me vendim të Ortakut të Vetëm;
- 13.3 Administratori do të kryejë detyrën e tij për një periudhë jo më të gjatë se 5 (pesë) vjeçare, me mandat të rinovueshëm, përveç rastit kur zëvendësohet sipas Statutit. Në kryerjen e detyrës së tij, Administratori do të tregojë kujdesin e duhur të një personi të besueshëm dhe të ndërgjegjshëm të biznesit dhe do të ruajë sekretin në lidhje me çështjet konfidenciale.
- 13.4 Administratori i parë i Shoqërisë, i emëruar për një mandat 5-vjeçar është:

**YARA HAWAY CABALLERO**, shtetase spanjolle, lindur më 21.04.1998, në Lagos (Nigeri), mbajtëse e pasaportës spanjolle me nr. PAR132191, dhe nr. personal A4876678500.

#### **Neni 14**

##### **Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia**

- 14.1 Në vazhdim të detyrimeve të përcaktuara në Nenet 13, 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të Shoqërive Tregtare, Administratori/ët duhet të:
- a. të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe në këtë Statut me mirëbesim dhe në interesin e Shoqërisë në tërësi duke i kushtuar vëmendje të veçantë impaktit që ka aktiviteti i shoqërisë në mjedis;
  - b. të ushtrojë detyrën e tij në përputhje me të drejtat që i jepen nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe ky Statut vetëm për qëllimet e përcaktuara këtu;
  - c. t'i kushtojë vëmendjen e duhur çështjeve për të cilat duhet të marrë vendim;
  - d. të shmangë çdo konflikt aktual dhe të mundshëm ndërmjet interesave të tij personale dhe atyre të Shoqërisë;
  - e. të ushtrojë funksionet e tij me kujdesin dhe vëmendjen e duhur dhe do të ruajë sekretet në lidhje me çështje konfidenciale;
  - f. të vë në dispozicion të Ortakut të Vetëm çdo të dhënë të lidhur me biznesin, të kërkuara nga Ortaku i Vetëm, brenda një kohe të arsyeshme dhe jo më vonë se 7 (shtatë) ditë. Informacioni dhe të dhënat duhet të jenë të përditësuara.

#### **Neni 15**

##### **Eksperti/ët Kontabël i/të Miratuar**

- 15.1 Eksperti/ët Kontabël i /të miratuar do të caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm nëse është e nevojshme. Mandati i audituesit, nëse caktohet një i tillë, duhet të rinovohet çdo vit.

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

- 16.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, që fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të secilit vit.

#### **Neni 17**

##### **Bilanci. Kontabiliteti**

- 17.1 Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet dhe t'i paraqitet organeve tatimore përpara fundit të Marsit të vitit pasues.
- 17.2 Librat kontabël duhet të mbahen në gjuhën Shqipe dhe vlerat përcaktohen në monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të ndara në monedhë të huaj, dhe këto shuma do të konvertohen çdo muaj në monedhën vendase.
- 17.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim, Shoqëria mund të vendosë si garanci kuotat e saj, ose mund të vendosë të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, me vendim të Ortakut të Vetëm.

**Neni 18**  
**Likuidimi**

- 18.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë shpërbërjen e Shoqërisë.
- 18.2 Me vendim të Ortakut të Vetëm do të emërohet një likuidator ose një grup likuidatorësh, të cilët do të merren me procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori/Likuidatorët do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban gjendjen e përgjithshme të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për kryerjen e këtij likuidimi. Në fund të këtij procesi, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë mbylljen e procedurës së likuidimit.

**Neni 19**  
**Ndryshimet në Statut**

- 19.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të modifikohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

**Neni 20**  
**Dispozita Përfundimtare**

- 20.1 Ky Statut përgatitet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast mospërputhje mes 2 versioneve, versioni në gjuhën angleze do të prevalojë.

Nënshkruar më 15.09.2023 nga:

**ORTAKU I VETËM**  
**YARA HAWAY CABALLERO**

*Përfaqësuar nga*

ERMAL MEMA

